



Monitorimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Kamëz

VITI 2019

Ky raport është hartuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH), në kuadrin e projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të lidhura me reduktimin e dhunës në familje të “Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020”. Projekti zbatohet në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave”, financuar nga Qeveria e Suedisë dhe që po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë

Përmbajtja e këtij manuali është vetëm përgjegjësi e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim, dhe nuk reflekton opinionin e SIDA,UNDP, UNFPA dhe UN Women.

Autorët

Megi Zylali – Qendra “Aleanca Gjinore për zhvillim”

Esmeralda Hoxha – Qendra “Aleanca Gjinore për zhvillim”

Tabela e permbajtjes

HYRJE.....	5
PËRSE MONITORIM I SKBGJ-SË NGA OSHC-TË?	6
METODOLOGJIA.....	6
MONITORIMI I QËLLIMIT TË III-TË STRATEGJIK TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2016-2020.....	8
GJETJET KRYESORE	8
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME DHUNËN NË FAMILJE NË BASHKINË KAMËZ	9
TË DHËNA STATISTIKORE NGA MEKANIZMI I REFERIMIT, BASHKIA KAMËZ	9
TË DHËNA STATISTIKORE NGA DREJTORIA E POLICISË KAMËZ	10
REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2019.....	11
KONKLUZIONE	17
REKOMANDIME	18

Shkurtime

ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BGj	Barazia Gjinore
DhBGj	Dhunë me bazë Gjinore
DhF	Dhunë në Familje
GTN	Grupi Teknik Ndërdisciplinor
INSTAT	Instituti i Statistikave në Shqipëri
KONVENTA CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KONVENTA E STAMBOLLIT	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
KD	Komiteti Drejtues
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGj	Nëpunës i Barazisë Gjinore
NjVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
QAGjZh	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
QZHK “Sot për të Ardhmen”	Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”
REVALB	Sistemi elektronik (on-line) i regjistrimit të rasteve të dhunës në Shqipëri
RrFGSh	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
SKBGj	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
ShGPS	Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës
UM	Urdhër Mbrojtjeje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UN WOMEN	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Hyrje

Ky raport u hartua në kuadër të Projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të OShC-ve për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve në lidhje me zvogëlimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020, nën Programin e Përbashkët të KB "Përfundimi i Dhunës ndaj Grave" të financuar nga Qeveria e Suedia po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA në partneritet me Qeverinë shqiptare Në Shqipëri projekti u zbatua nga Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, nga disa nga anëtarët e Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri dhe disa organizata të tjera joqeveritare. Bashkitë e përfshira në monitorim ishin bashkitë e Lezhë, Kamëz, Fier, Sarandë dhe Pogradec.

Qëllimi i projektit është monitorimi i i detyrimeve ndërkombëtare dhe kombëtare të Shqipërisë për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndërsa rezultati i pritur në terma afatgjatë është ulja e fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri. Proçesi monitorues i SKBGj dhe PKV 2016-2020 pr bashkitë e lartpërmenduar u zhvillua përgjatë periudhës nëntor 2019- Maj 2020. Aktivitetet në nivel qendror u monitoruan nga QAGjZh dhe në nivel lokal nga disa prej anëtareve të RrFGSh i dhe disa organizata të tjera, përmes mbledhjes së të dhënave zyrtare lidhur me zbatimin të Qëllimit strategjik 3 të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016 – 2020.¹

Gjatë zbatimit të projektit u arrit që:

1. Organizatat partnere në projekt të rrisin për të monitoruar zbatimin e Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020 dhe punën e mekanizmave të referimit kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.
2. Procesi i monitorimit nga u përfundua me sukses brenda afateve të zbatimit të projektit pasi edhe pse nën ndikimin e krizës COVID-19, institucionet përgjegjëse dërguan në kohën e duhur informacionet e kërkuara zyrtarisht.
3. U realizua procesi i promovimit dhe advokimit, për zbatimin e objektivit të 3-të të SKBGj 2016-2020, duke përdorur gjetjet dhe rekomandimet e proceseve monitoruese.

Ky projekt, e nisi punën me organizimin e seancave informuese me përfaqësuesit e organizatave partnere në 5 bashkitë nën monitorim, bazuar në udhëzuesin për monitorimin e Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, të realizuar nga GADC në nëntor 2019. Përvec manualit u hartuan skedat monitoruese bazuar në indikatorët për monitorimin e zbatimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, të cilat u përdorën gjatë procesit të monitorimit

Rreth organizatave zbatuese

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGjZh) është një organizatë jo-fitimprurëse shqiptare që vepron dhe punon në të gjithë Shqipërinë për fuqizimin e grave dhe për të krijuar një të ardhme të barabartë dhe të drejtë për vajzat dhe gratë me të ardhura të ulëta në të gjithë Shqipërinë, duke u përpjekur për t'i nxjerrë nga varfëria dhe përjashtimi. Për të mbrojtur të drejtat e grave dhe për t'i fuqizuar ato, QAGjZh ngre fonde kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fushat kryesore të ekspertizës së QAGjZh-së janë:

- Promovimi i paqes dhe përpjekjet për ti dhënë fund dhunës me bazë gjinore;
- Garantimi i fuqizimit ekonomik të grave;

¹ <https://www.un.org.al/sites/default/files/SKGJB-AL-web.pdf>

- Sipërmarrjet e grave;
- Fuqizimi i qytetarëve për të monitoruar axhendën gjinore lokale;
- Rritja e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Përmirësimi i të drejtave të grave në zona rurale.

Gjatë procesit të monitorimit të bashkive Fier, Lezhë, Pogradec, Sarandë dhe Kamëz QAGJZh bashkëpunoi me një pjesë të organizatave të Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri - RrFGSh , si dhe me disa organizata të tjera të cilat veprojnë në territorin e bashkive nën monitorim si: Qendra Rinore Vlorë, Epoka e Re Fier, Tjetër Vizion Elbasan dhe Shoqata për Integrimin e Zonave Informale Kamëz.

Përse monitorim i SKBGj-së nga OShC-të?

Përgjegjshmëria në qeverisje është një element i rëndësishëm që përcakton marëdhëniet midis atyre që ushtrojnë fuqinë e pushtetit dhe atyre në emër të të cilëve ushtrohet kjo fuqi. Në sistemet demokratike, fuqizimi i sistemeve të transparencës dhe përgjegjshmërisë është prioritet i vazhdueshëm, që sigurohet përmes mekanizmeve të ndërtuar, që përmirësohen vazhdimisht e që garantojnë pjesëmarrjen aktive në vendimmarrjen publike të shoqërisë civile, OShC-ve apo vetë përfaqësuesve të komuniteteve lokale. Këto mekanizma forcojnë proceset demokratike, sigurojnë zhvillim efektiv përmes dhënies së shërbimeve efektive, lehtësojnë procesin e mirëqeverisjes dhe fuqizojnë grupet më vulnerabël të komuniteteve, siç janë vajzat e gratë viktimat të dhunës në familje.

Ndërkohë që ligjet dhe strategjitë kombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e vajzave e grave dhe dhunën në familje/ me bazë gjinore janë hartuar me kontributin e vyer e të pakursyer të OShC-ve të grave, deri tashmë kjo rutinë nuk është shoqëruar me procese monitoruese e vlerësuese nga vetë OShC-të. Organizatat e grave në Shqipëri kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme për të monitoruar dhe vlerësuar strategjitë dhe planet e veprimit në fushën që ato punojnë çdo ditë. Mbi të gjitha, ato për shumë vite kanë luajtur një rol vendimtar në adresimin e dhunës ndaj grave nëpërmjet ofrimit të shërbimeve, rritjes së ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve, lobimit dhe avokimit, duke u bërë kështu aktorë kyç në nivel vendor e kombëtar.

OShC-të janë shumë të interesuara që të monitorojnë strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit, në mënyrë që të ketë një të kuptuar më të mirë të asaj që qeveria po bën në këtë drejtim. Qëllimi përfundimtar është që të zbatojmë një proces monitorimi të paanshëm që do të sigurojë një zbatim më të mirë të hapave të ardhshëm që do ndërmerren për reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe avancimin e barazisë gjinore në shoqëri. Vlen të theksohet se Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS), e ka mirëpritur këtë nismë dhe ka theksuar se ky monitorim nga shoqëria civile do të shërbejë për të informuar edhe procesin e monitorimit të brendshëm të SKBGj 2016-2020 nga institucionet përgjegjëse.

Metodologjia

Për të kryer monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2016-2020 dhe Planit të Veprimit u ndoq një qasje e dyfishtë metodologjike në mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore. Një eksperte lokale u përzgjedh për çdo bashki të targetuar të ngarkuara për të ndjekur punën e bashkisë përkatëse dhe mbledhjen e të dhënave për periudhën janar – dhjetor 2019.

Procesi i mbledhjes së të dhënave është kryer si më poshtë vijon:

1. Mbledhja e të dhënave përmes takimeve informuese me zyrtarë lokal publik. Faza e parë ishte kontakti me kryetarët e bashkive të targetuara për njoftimin e tyre mbi iniciativën e monitorimit. Më pas monitorueset kontaktuan përmes një formati të njësuar koordinatorin vendor të dhunës pranë bashkisë dhe kurdo që ishte e mundur drejtorinë e shërbimeve sociale, drejtorinë e

shëndetit, organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në territorin e bashkisë, zyrtarët e gjykatave të rrethit, komunitetet fetare, mediat, organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të përfshirë në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Qëllimi i këtyre takimeve ishte vendosja e kontaktit që më pas u ndoq me kërkesa për informacion, të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera mbi punën e kryer nga bashkia dhe institucione të tjera për adresimin e objektivit të tretë të SKBGj për eliminimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Monitorueset gjithashtu kanë ndjekur takimet e zhvilluara në kuadër të mekanizmit të referimit në bashki dhe kanë raportuar mbi përmbajtjen e tyre dhe vendimet e marra.

2. Mbledhja e të dhënave përmes burimeve zyrtare e statistikore. Përmes të drejtës për informim monitorueset kanë kërkuar të gjithë dokumentet mbështetëse të punës së bashkisë në kuadër të luftës kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Specifikisht:

- Janë mbledhur minutat mbi takimet e mekanizmit të referimit për çdo bashki, që kanë plotësuar informacionet e ndara me monitorueset përmes intervistave.
- Janë marrë të dhëna statistikore mbi prevalencën e dhunës në familje nga gjykatat, shërbimi i provës, bashkia, policia, shërbimi social dhe INSTAT.
- Është analizuar buxheti vjetor i bashkisë për të identifikuar burimet financiare të alokuara për zbatimin e SKBGj në luftën kundër dhunës në familje.
- Janë mbledhur materiale mbështetëse për aktivitetet ndërgjegjëse të zhvilluara nga ana e bashkisë për përmbushjen e objektivit 3.1.

Raporti i monitorimit ndjek strukturën e objektivave specifike të SKBGj sa i përket dhunës me bazë gjinore si edhe aktivitetet specifike të planit të veprimit. Për këtë është hartuar një skedë monitoruese e cila është plotësuar në vijimësi nga monitorueset përmes informacionit të akumuluar përgjatë periudhës monitoruese.

Bazuar tek skeda monitoruese është bërë vlerësim i përmbushjes së angazhimeve të bashkive të targetuara nën objektivin e tretë të SKBGj duke identifikuar nga njëra anë praktikatat pozitive prej të cilave mund të përfitojnë edhe bashki të tjera dhe nga ana tjetër sfidat dhe mangësitë me të cilat përballen bashkitë, për të identifikuar mundësitë për përmirësim në periudhën e mbetur të planit të veprimit të SKBGj.

Për të kryer monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore janë përdorur edhe të dhënat e sistemit REVALB. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UNDP ka hartuar dhe miratuar bazën e nevojshme ligjore për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Bashkërendimit të Punës dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje në mënyrë që të parandalohen, raportohen dhe trajtohen me efektivitet rastet e dhunës në familje.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, dt 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” përcakton midis të tjerave dhe detyrimet konkrete të institucioneve shtetërore përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, raportimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Sistemi online në lidhje me statistikatat për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel bashkie është lançuar në vitin 2014. Ky sistem online regjistron çdo rast dhune, monitoron si po ecën referimi i rastit dhe ku ka ngecur ai, duke siguruar që t’i shkojë deri në fund çdo rasti të raportuar të dhunës në marrëdhëniet familjare. Sistemi online është i sigurt dhe respekton fshehtësinë e të mbijetuarave të dhunës. Ai përdoret nga një numër i kufizuar i nëpunësve vendorë dhe qendrorë, të cilët janë trajnuar posaçërisht për përgjigjen ndaj dhunës në familje, fshehtësinë e të dhënave të së mbijetuarës dhe për përdorimin e sistemit. Ky sistem aksesohet nga të gjitha bashkitë në nivel lokal dhe MShMS në nivel qendror në adresën www.revalb.org

Mbi bazën e të dhënave të hedhura, sistemi prodhon raporte interaktive dhe të mundshme për t'u printuar në kohë reale të cilat kontribuojnë në: hartimin e politikave; matjen e efektivitetit të Grupeve Teknike Ndërdisciplinore (GTN) të ngritura në nivel lokal; përmirësimin e të dhënave statistikore të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal; në marrjen e masave për mirë-funksionimin e mekanizmit referues në të gjitha njësitë vendore; Kryerjen e analizave statistikore, për të identifikuar probleme si dhe fusha ku ka nevojë për ndërhyrje; për të shmangur të gjitha dyshimet për të dhënat e pavërteta ose shifrat e gabuara, që çojnë në rritjen e besimit dhe përmirësimin e shkallës së bashkëpunimit midis aktorëve dhe të atyre që përfitojnë prej saj.

Të dhëna të përgjithshme për Bashkinë Kamëz

Sipas Censurit të vitit 2011, Kamza ka 104190 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 125632 banorë. Me një sipërfaqe prej 37.18 km², bashkia Kamëz ka një densitet prej 2802 banorë/km² sipas Censurit 2011 ndërkohë që sipas të dhënave të Regjistrimit Civil densiteti është 3519 banorë/km². Numri më i madh i familjeve është përqendruar në njësinë administrative Kamëz me 23,246 familje.

Kryeqendra e bashkisë së re është Kamza, në përbërje të së cilës ndodhen 14 fshatra. Nga këto në përbërje të njësisë administrative Kamëz janë fshatrat e mëposhtme: Bathore, Laknas, Valias, Frutikulturë, Bulçesh, Zall-Mner; ndërsa në përbërje të njësisë administrative Paskuqan janë fshatrat: Paskuqan, Babrru Qëndër, Kodër e Kuqe, Shpat, Fushë e Kërçikëve, Kodër Babrru, Paskuqan Fushë, Paskuqan Kodër. Të dyja njësitë administrative janë pjesë e Rrethit të Tiranës, në Qarkun e Tiranës.

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2019. Raporti do të pasurohet më tej me statistikat vjeçare për 2019, përgjatë muajit janar 2020.

Gjetjet Kryesore

- Gjatë vitit 2019, Mekanizmi i Koordinuar i Referimit pranë bashkisë Kamëz ka trajtuar 51 raste të viktimave të dhunës në familje.
- Në Bashkinë Kamëz përgjatë vitit 2019 janë evidentuar 216 raste dhune në familje pranë Komisarariatit të Policisë nr.5 nën juridiksionin e kësaj bashkie.
- Janë paraqitur nga viktimat e dhunës 129 kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje.
- Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë për bashkinë Kamëz gjatë vitit 2019 pranoi dhe lëshoi 95 Urdhra Mbrojtje dhe Urdhra të Menjëhershëm të Mbrojtjes.
- Databaza pranë kësaj bashkie me të dhënat e gjykatës në lidhje me UM/UMM nuk është e plotë kjo për arsye teknike dhe për mungesë të ruajtjes së një kopje në mënyrë alternative.
- Përgjatë 2019-ës u identifikuan 66 vepra penale të nenin 130/a dhe u arrestuan 28 autorë.
- Marrëveshja e anëtarëve të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit është nënshkruar në muajin Prill 2018. (Bashkia Kamëz; Komisarati i Policisë nr. 5, Qendra Shëndetësore, Zyra Rajonale e

Punësimit, Zyra Arsimore Kamëz, Qendra Kombëtare për trajtimin e Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”.)

- Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci” ka lobuar në mënyrë të vazhdueshme që Zyra Lokale e Punës të rikthehet përsëri në Bashkinë Kamëz, pasi në vitin 2017 është zhvendosur në Tiranë dhe aksesimi i grave/vajzave në këtë zyrë është shumë i vështirë.
- Bashkia Kamëz përgjatë vitit 2019 ka organizuar 6 aktivitete ndërgjegjësuese me komunitetin në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile që operojnë në territorin e saj.
- Mekanizmi i Referimit pranë kësaj bashkie ka organizuar 12 mbledhje të GTN-së, ndërkohë që nuk është organizuar asnjë mbledhje e Komitetit Drejtues.
- Bashkia Kamëz ka edhe një dokument të miratuar në vitin 2018 në lidhje me Procedurat Standarte të Veprimit “Mbrotjtja nga Dhuna në Familje” si dhe që prej muajit mars të vitit 2019 në Bashkinë Kamëz ka një kordinator vendor për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.
- Sistemi REVALB nuk ka funksionuar, njësoj si në pjesën më të madhe të bashkive në monitorim
- Pranë Strehëzës Kombëtare në Kamëz, përgjatë vitit 2019 janë trajtuar 4 raste viktime të dhunës në familje.
- Përgjatë vitit 2019 nuk ka patur raste të viktimave të dhunës në familje të cilat kanë përfituar bonus qeraje.
- 15 ishin viktimat e pajisura me Urdhër Mbrotjtje apo të menjëhershëm Mbrotjtje që kanë përfituar asistencë prej 3000 lekësh në muaj përgjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së UM/UMM.
- Objektivi 3.3 për rehabilitimin e dhunuesve nuk zbatohet pranë kësaj bashkie.

Të dhëna statistikore në lidhje me dhunën në familje në Bashkinë Kamëz

Të dhëna statistikore nga Mekanizmi i Referimit, Bashkia Kamëz

Përgjatë vitit 2019 Mekanizmi i Referimit pranë bashkisë Kamëz ka trajtuar në bashkëpunim me Koordinatorin vendore dhe anëtarët e mekanizmit 51 raste të viktimave të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore.

Disa prej rasteve të trajtuara detajohen në tabelën më poshtë

Tabela 1: Rastet e dhunës të trajtuara nga Mekanizmi i Referimit Bashkia Kamëz

Raste të trajtuara nga Mekanizmi i Referimit	Përshkrimi i rastit
Grua viktimë e dhunës në familje me 2 fëmijë	Viktima 29 vjeç e martuar dhe ka dy fëmijë 6 dhe 2 vjeç, banuese në Vorë por është kthyer bashke me fëmijët pranë familjes së saj në Bathore. Rasti është paraqitur në Komisaratin e Policisë nr.5 në datën 27 Maj 2019 ku ka bërë denoncimin se është dhunuar psikologjikisht nga bashkëshorti i saj ku i është plotësuar Urdhër i Menjëhershëm Mbrotjtje. Bashkëshorti është personi që në mënyrë të vazhdueshme ka ushtruar dhunë psikologjike dhe

	<p>fizike kjo për shkak se është konsumues i alkolit. Sipas saj debatet dhe konfliktet me bashkeshortin në shumicën e rasteve ndodhin në praninë e fëmijëve. Rasti ndiqet duke qenë se vijon të ketë UM.</p>
<p>Grua viktimë e dhunës në familje me 3 fëmijë</p>	<p>Familja përbëhet nga 5 anëtare, jetojnë në zonën e Frutikutures në Kamëz. Familja me përpara ka qenë azilante, edhe atje ka filluar dhuna e bashkeshortit ndaj zonjës. Janë rikthyer nga azili, babai i ka braktisur bashkeshorten sëbashku me tre fëmijët, ka ushtruar dhunë ndaj bashkeshortes. Rasti është pajisur me Urdhër Mbrojtje ndaj bashkeshortit, vjerrit dhe kunatit. Momentalisht po jeton bashkë me fëmijët dhe po trajtohet me pagesën e UM. Gjithashtu rasti është referuar për punësim në një ndërrmarje këpucarie.</p>
<p>Grua viktimë e dhunës në familje me 1 fëmijë.</p>	<p>Viktima 21 vjec lindur në Martanesh dhe banuse në Zallher .E martuar prej pesë vitesh dhe ka një fëmijë 3-vjec. Rasti është paraqitur në Komisaritat me DT 24 Maj 2019 për të kërkuar plotesimin e UM pasi është e kercenuar nga bashkeshorti i saj i cili gjatë periudhës që ka qenë në burg, për tu larguar nga banesa dhe femijen ta lërë në shtëpinë e bashkeshortit. Nga kërcenimet e vazhdueshme është detyruar të largohet dhe femijen ta lërë në shtëpinë e bashkeshortit. Prej rreth pesë muajsh po jeton në një banesë me qera dhe është punësuar në një rrobaqepesi. Pas daljes së bashkeshortit nga burgu ajo ka kërkuar të rregullojë marrdheniet dhe të jetojnë të tre larg familjes së tij por nga bashkeshorti i saj nuk është ofruar asnjë mundësi për të bashkuar familjen duke mos e lejuar të takoje as femijen e saj.</p>

Të dhëna statistikore nga Drejtoria e Policisë Kamëz

Në Bashkin Kamëz përgjatë vitit 2019 janë evidentuar 216 raste dhune në familje pranë Komisarariatit të Policisë nr.5 nën juridiksionin e bashkisë Kamëz. 178 prej rasteve të dhunës ishin kundrejt grave dhe vajzave. Ndërkohë që u paraqitën nga viktimat e dhunës 129 kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje. Përgjatë 2019-ës u evidentuan 66 vepra penale të nenin 130/a dhe u arrestuan 28 autorë. Detaje më të hollësishme pasqyrohen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2: Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Bashkisë Kamëz

Bashkia Kamëz	Raste
Evidentuar	216
Të dëmtuar gjithsej	220
Prej tyre gra/vajza	178
Kërkesë për U.Mbrojtje	129
Shkelje U.Mbrojtjes	8
V. P. Neni 130/a	66
Arrest. për 130/a	28
Ndaluar për 130/a	4
Gjendje të Lirë për 130/a	32
Në kërkim për 130/a	2
Autorë të vetëvrarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Rezultatet e Monitorimit – Viti 2019

Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Mekanizmi i Referimit pranë bashkisë Kamëz ka për detyrë ndjekjen e rastit dhe plotësimin e nevojave të viktimës së dhunës në familje duke siguruar edhe adresimin në shërbimet e përshtatshme; koordinimi dhe mbikëqyrja e ofrimit të shërbimeve; menaxhimi i rasteve të dhunës; shkëmbimi i të dhënave të rasteve konkrete ndërmjet institucioneve; monitorimi i mënyrës së funksionimit të të gjithë sistemit si dhe raportimi në institucionet e prapë. Institucionet përgjegjëse për funksionimin e Mekanizmit të Referimit janë: Bashkia, e cila luan rol drejtues në ngritjen, konsolidimin, monitorimin dhe vazhdimësinë e mekanizmit të referimit të rasteve të dhunës; komisarati i policisë, qendrat shëndetësore, Qendra Kombëtare e Trajtit të Viktimave të Dhunës në Familje, zyra e Ndhmës Ekonomike, zyra vendore e Punësimit, drejtoritë arsimore, organizatat jofitimprurëse.

Ndërkaq, anëtarët e Mekanizmit të Referimit janë një grup teknik ndërdisiplinor që mbikëqyr dhe koordinon ofrimin e shërbimeve si dhe kryen menaxhimin e rasteve konkrete të dhunës në familje.

Marrëveshja mes palëve është nënshkruar në muajin Prill 2018. Kjo marrëveshje u nënshkrua për nisjen e funksionimit të MKR duke marrë kështu përsipër detyra dhe përgjegjësi nga:

1. Bashkia Kamëz;
2. Komisarati i Policisë nr. 5,
3. Qendra Shëndetësore,
4. Zyra Rajonale e Punësimit,

5. Zyra Arsimore Kamëz,
6. Qendra Kombëtare për trajtimin e Viktimave të Dhunës në Familje,
7. Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”.

Qendra e të Drejtave të Njeriut në Demokraci (QDNJ)

Roli i QDNJD-së në Mekanizmin e Kordinuar të Referimit të riaktivizuar në vitin 2018, lidhet me mbështetjen e riaktivizimit të Mekanizmit të Referimit në këtë Bashki me qëllim menaxhimin në mënyrë të koordinuar të rasteve të dhunës kundër grave. QDNJD është pjesë aktive e të gjitha mbledhjeve të Mekanizmit të organizuara nga Bashkia Kamëz.

Në vitin 2018 QDNJD me mbështetjen e UN Women, ka riaktivizuar dhe mbështetur Mekanizmin e Kordinuar të Referimit në Bashkinë Kamëz. Në vitin 2018 QDNJD dhe Strehëza Për Gra dhe Vajza të Dhunuara kanë nisur zbatimin e projektit “Rritja e Kapaciteteve të Ofruesve të Shërbimeve për Gratë/Vajzat e Prekura nga të Gjitha Format e Dhunës” në Bashkite Kamëz dhe Lezhe. Projekti financohet nga Komisioni Europian dhe zbatohet me mbështetjen e UN Women.

QDNJD ofron shërbime ligjore si konsulencë juridike dhe përfaqësim në gjykatë për çështjet me objekt lëshimin e Urdhërit të Mbrojtjes/ urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes.

Gjithashtu QDNJD ka kryer trajnime me institucione përgjegjëse të linjës si Komisaratin e Policisë Kamëz, Bashkinë Kamëz dhe Njësitë Administrative në varësi të saj, qendrat shëndetësore, mësuesit në shkollë me qëllim ngritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve publike me qëllim ofrimin e shërbimeve adekuate dhe cilësore për gratë viktime të dhunës dhe dhunës në familje, QDNJD ka kryer 64 trajnime në këto institucione në të cilat ka pasur 817 pjesëmarrës.

QDNJD me qëllim rritjen e njohurive të komunitetit mbi legjislacionin mbi dhunën kundër grave dhe mjetet ligjore për mbrojtje ka zhvilluar takime informuese në komunitet në zona të ndryshme të Bashkisë Kamëz. Gjithsej janë zhvilluar 33 takime informuese në komunitet dhe kanë marrë pjesë 718 gra/vajza. QDNJD është angazhuar edhe në aktivitete të lobimit dhe avokimit duke adresuar çështje të ndryshme që afektojnë në mënyrë direkte ose indirekte viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Ndër të tjera kjo qendër ka ofruar konsulencë juridike dhe përfaqësim në gjykatë për një numër të konsiderueshëm grash/vajzash.

QDNJD ka lobuar në mënyrë të vazhdueshme që Zyra Lokale e Punës të rikthehet përsëri në Bashkinë Kamëz, pasi në vitin 2017 është zhvendosur në Tiranë dhe aksesit i grave/vajzave në këtë zyrë është shumë i vështirë.

QDNJD i ka dërguar disa relacione Drejtorisë së Përgjithëshme të Policisë së Shtetit si dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë lidhur me problematikat që ka konstatuar në Komisaratin e Policisë nr. 5 me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Gjithashtu kjo qendër ka adresuar çështjen e lëshimit të raporteve të posaçme mjekësore nga Qendrat Shëndetësore ka qënë një tjetër çështje që është ngritur gjatë punës së QDNJD-së.

Bashkia Kamëz, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, ka zhvilluar disa aktivitete me gratë dhe vajzat në territorin e kësaj bashkie. Gjithashtu në disa raste takimesh dhe aktivitete target grupe të përfshira kanë qenë edhe burra dhe djem në kuadër të ndërgjegjësimit të shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Në bashkëpunim me USAID-in kjo bashki përgjatë vitit 2019 ne date 28.05.2019 ka zhvilluar edhe një takim në ambjentet e sallës së këshillit bashkiak. Te pranishem ne takim kane qene 26 persona. Tema e takimit ishte "Aspektet kryesore te fuqizimit te grave ne nivel lokal.

Bashkia Kamëz përgjatë vitit 2019 ka organizuar 6 aktivitete ndërgjegjësuere me komunitetin në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile që operojnë në territorin e saj.

Gjithashtu bashkia Kamëz në datë 04.10.2019 organizoi një tryezë të rrumbullakët me të gjithë përfaqësuesit e institucioneve pjesë të mekanizmit për identifikimin e sfidave për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe ndjekjen e detyrave dhe përgjegjësive të secilit prej aktorëve pjesë të këtoij mekanizmi.

Ndërkohë që në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit, në datë 25.11.2019 u organizua nga Bashkia Kamëz dhe u zhvillua nje marshim i cili perfshiu nxënësit e dy shkollave të mesme dhe anëtarët e mekanizmit të referimit.

Ndërkaq kjo bashki nuk ka fond të veçantë të alokuar për shërbimet në lidhje me dhunën në familje apo për ndërgjegjësimin e komunitetit. I vetmi fond është ai që parashikon pagën mujore për punonjësen që vepron si koordinatore vendore.

Tabela 3. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Nr	Data	Vendi	Tema	Organizua nga:
1	3.1.2019	Bashki	Prindërimi Pozitiv – testojmë familjen” – Me gratë viktimat të dhunës në familje – Bashkia dhe World Vizion	Bashkia Kamëz
2	8.3.2019	Bashki	Me nxënësit e shkollave “Ibrahim Rugova” – Elez Isuf Ndreu – Qendra e të drejtave në dekmokraci, anëtarërt e mekanizmit dhe viktimat e dhunës në familje – Funkionimi i mekanizmit të referimit.	Bashkia Kamëz
3	3.5.2019	Laknas	Takim me mësuesit e shkollës Don Nikoll Kaçori, Laknas, për funmskinimi e mekanizmit të dhunës në fmialje	Bashkia Kamëz
4	28.5.2019	Bashki	Fuqizimi i grave në bashkëpunim me USAID	Bashkia Kamëz

5	30.7.2019	Bashki	Vlerësimi i funksionimit të mekanizmit të referimit	Bashkia Kamëz
6	25.11.2019	Kamëz	16 ditët e aktivizmit, marshim me nxënësit Ibrahim Rugobva dhe Elez Ndreu (3 aktivitete në shkollë dhe në bashki) takimi i mekanizmit të referimit.	Bashkia Kamëz

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Bashkia Kamëz, në zbatim të Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, i ndryshuar, VKM-së nr. 334, datë 17.02.2011 “Për Mekanizmin e Bashkërendimit të Punës për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Mënyrën e Procedimit të Tij”, ka ngritur Mekanizmin e Referimit në Kamëz në Prill të vitit 2018

Pranë mekanizmit të referimit të bashkisë Kamëz ka vijuar me përmirësimë bashkëpunimi ndër-institucional duke tejkaluar vështirësitë e para për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve në çdo takim megjithëse vijojnë disa institucione që mos të jenë të pranishme.

Bashkia Kamëz ka edhe një dokument të miratuar në vitin 2018 në lidhje me Procedurat Standarte të Veprimit “Mbrojtja nga Dhuna në Familje” si dhe që prej muajit Mars të vitit 2019 në Bashkinë Kamëz ka një kordinator vendor për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Fillimisht funksionet e kordinatorit vendor i mbulonte Punonjësi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Koordinatorja është emëruar në këtë pozicion në datë 24 Maj 2019 dhe kryen vetëm detyrat e koordinatorës pranë kësaj bashkie ashtu siç është specifikuar edhe në kontratën e punës.

Trajnimet e marra për këtë pozicion janë të pakta, duke patur parasysh edhe periudhën e shkurtër që ka në këtë sektor. Takimet janë bërë në periudhën Qershor, Korrik, Shtator (trajnimet nga Ministria e Mbrojtjes Sociale dhe nga organizata të ndryshme): “Barazia gjinore dhe buxhetimi i përgjegjshëm”, “Çështjet praktike të zbatimit të legjislacionit kundër dhunës në familje”, “Ngritje kapacitetesh për profesionistët që punojnë me menaxhimin e familjeve”.

Përgjatë vitit 2019 bashkëpunimi i bashkisë Kamëz me Drejtorinë Vendore të Policisë Kamëz ka qënë shumë i mirë dhe bashkëpunues. Nga komisariati i policisë Kamëz janë plotësuar 126 Urdhra të Mbrojtjes dhe 5 Urdhra të Menjëhershëm të Mbrojtjes.

Përgjatë vitit 2019, GTN e bashkisë Kamëz është mbledhur 12 herë, periodikisht çdo muaj por asnjë mbledhje e Komitetit Drejtues nuk është realizuar.

Bashkëpunimi i kësaj bashkie me një pjesë të anëtarëve të Mekanizmit të Referimit për vitin 2019 raportohet i niveleve të mira dhe bashkëkoordinuese për çdo rast të paraqitur. Por, këtu theksohet se me Shërbimin Social nuk ka patur një marrëveshje bashkëpunimi të drejtëpërdrejtë por me Strehëzën Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje e cila është nën varësinë e Shërbimit Social.

Mospjesëmarrja e disa përfaqësuesve të disa institucioneve si përmbairimi, prokuroria apo gjykata në mbledhjet e GTN-së justifikohet nga koordinatori si i panevojshëm në rastet që kanë trajtuar megjithëse parashikohet në rregulloren e mekanizmave të referimit. Kjo për pasojë sjell edhe mos pasje të saktë dhe të plotë të rasteve të UM/UMM të lëshuara nga kjo gjykatë.

Pranë Strehëzës Kombëtare në Kamëz, përgjatë vitit 2019 janë trajtuar 4 raste viktime të dhunës në familje.

Ndërkohë që përgjatë vitit 2019 nuk ka patur raste të viktimave të dhunës në familje të cilat kanë përfituar bonus qeraje. Ndërkohë që 15 ishin viktimat e pajisura me Urdhër Mbrojtje apo të menjëhershëm Mbrojtje që kanë përfituar asistencë prej 3000 lekësh në muaj përgjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së UM/UMM.

Tabela 4. Numri i mbledhjeve të GTN-së ne vitin 2019 në Bashkinë Kamëz

Viti	Mbledhjet e GTN
2019	24.01.2019 Takim per mekanizimin e referimit për muajt Dhjetor 2019-Janar 2019
	26.02.2019 Trajtime rastesh
	25.03.2019 Trajtime rastesh
	26.04.2019 Trajtime rastesh
	31.05.2019 Trajtime rastesh
	18.06.2019 Trajtime rastesh
	19.07.2019 Trajtime rastesh
	22.8.2019 Trajtime rastesh
	06.09.2019 Trajtime rastesh
	22.10.2019 Trajtime rastesh
	25.11.2019 Trajtime rastesh
	30.12.2019 Trajtime rastesh

Tabela 5. Numri i mbledhjeve të KD-së sipas viteve në Bashkinë Kamëz

Viti	Mbledhjet e KD
2019	Nuk janë organizuar mbledhje të Komitetit Drejtues përgjatë vitit 2019

Tabela 6. Përbërja e Komitetit Drejtues të bashkisë Kamëz

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Kryetar Rakip SULI
Drejtoria e Policisë	Drejtues I pare Rebani Jaupi
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	-
Prokuroria e Rrethit	-
Drejtoria Arsimore Rajonale	Ermioni Cekani
Drejtoria e Shëndetit Publik	Edmond Drixhi
Zyra e Përmbartimit	-
Prefektura	-
Qendra Shëndetësore	Viola Fera
QDNJ	Afërdita Prioni

Burimi: Bashkia Kamëz**Tabela 7. Përbërja e GTN-së Bashkia Kamëz viti 2019**

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Kordinatori vendor I dhunes Arjola Gjuta
Drejtoria e Policisë	OPGJ Luisida Shqypi, SPZ e zones Fran Gjini etj
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Nuk marrin pjese
Prokuroria e Rrethit	Nuk marrin pjese
Drejtoria Arsimore Rajonale	Psikologët e shkollave ose drejtori I zyres arsimore ne varesi te rastit
Drejtoria e Shëndetit Publik	
Zyra e Përmbartimit	Nuk marrin pjese
Prefektura	Nuk marrin pjese
Kryetarët e Njërive Administrative	Nuk marrin pjese
Zyra e Punësimit	Specialist te zyres se punes Enes Haxhiu
Organizata Jo qeveritare	World Vision Ornela Saraci
Strehëzat për viktimat e dhunës	Menaxheret e rastit Alfrida Koroni, Ervisa Jusufaj
Komunitete fetare	Nuk marrin pjese
Dhoma e Avokatisë së Rrethit	Nuk marrin pjese

Burimi: Bashkia Kamëz

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.

Gjykata e Rrethit Tiranë nuk bën ndarje statistikore të rasteve të lëshimit të Urdhra Mbrojtje (UM) dhe Urdhra të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) sipas bashkive, gjinisë apo moshës. Pranë kësaj gjykate mungon një zyrë e tillë dhe me gjithë rekomandimet ndër vite akoma nuk është ngritur.

Në këtë situatë për statistikën zyrtare të UM/UMM të mbërritura nga gjykata Tiranë për bashkinë Kamëz u mor për bazë informacioni i koordinatores së kësaj bashkie. Rezulton që pranë MKR Kamëz janë të regjistruar 95 Urdhra Mbrojtje dhe Urdhra të Menjëhershëm të Mbrojtjes. Të dhënat u mblodhën dhe u përpunuan bazuar në dosjet fizike për secilin rast, duke qenë se databaza elektronike për arsye teknike është fshirë dhe ka të regjistruar vetëm rastet e muajve të fundit të vitit 2019.

Megjithëse nuk është pjesë e MKR, Shërbimi i Provës rezulton të jetë jo funksional edhe pse ligji parashikon që ky institucion dhe gjykata duhet të bashkëpunojnë në mënyrë të ngushtë për dhënien e dënimeve alternative për dhunuesit.

Pranë bashkisë Kamëz nuk ka një program përsa i përket dhënies së mundësisë për rehabilitimin e dhunuesve nëpërmjet programeve të specializuara, ndaj edhe përsëritja e dhunës në familje ndodh shpesh pranë kësaj bashkie

Paralelisht, në territorin e kësaj bashkie nuk ka as organizata të shoqërisë civile të cilat mund të ofrojnë shërbime të ngjashme në lidhje me plotësimin e objektivit të tretë të strategjisë.

Konkluzione

- Mekanizmi i Referimit pranë kësaj bashkie nuk funksionon i plotë, për aq kohë sa në mbledhjet e GTN-së vijojnë të mungojnë përfaqësues të institucioneve kryesore si Gjykata, Prokuroria, Zyra e Përmbartimit, Mjeku Ligjor.
- MKR pranë bashkisë Kamëz ka trajtuar 51 raste të viktimave të dhunës në familje përgjatë vitit 2019, një tregues i mirë ky krahasuar me rastet si dhe me bashkitë e tjera nën monitorim.
- Koordinatorja pranë kësaj bashkie duhet të ketë mbështetjen dhe bashkëpunimin e të gjithë anëtarëve të MKR për të kryer detyrat që diktohen me ligj, duke qenë se Kamza është një prej të pakta bashkive që koordinatores kryen vetëm detyrat që i paracakton pozicioni.
- Komiteti Drejtues si rregullator i politikave që duhet të ndjekë Mekanizmi i Referimit përgjatë vitit 2019 nuk u mblodh asnjëherë, edhe pse ka patur ndryshime në ligjin e dhunës në familje.
- Zyra e Punës pranë kësaj bashkie është hequr dhe megjithëse po llobohet për kthimin e saj në Kamëz, akoma nuk ka një veprim konkret, kjo sjell vështirësi për të gjithë komunitetin por sidomos për gratë viktime të dhunës në familje.

- Sistemi REVALB, njësoj edhe si në bashkitë e tjera përgjatë vitit 2019 ka qenë jo funksional dhe në pjesën më të madhe të vitit jo efikas, duke sjellë kështu mangësi të pasqyrës statistikore të rasteve të dhunës pranë kësaj bashkie.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ofron të dhëna statistikore të ndara për rastet e UM/UMM të bashkisë Kamëz, fakt ky dalë në pah gjatë monitorimit.
- Bashkia Kamëz nuk ka një databazë elektronike të plotë të vitit 2019 në lidhje me të dhënat e UM/UMM të mbërritura nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe që i përkasin kësaj bashkie. Pajisjet kompjuterike kanë pësuar difekt teknik dhe nuk kanë kopje elektronike të ruajtura në back – up të këtyre statistikave, përveç vendimeve fizike të mbërritura nga gjykata.
- Megjithëse pohohet nga koordinatorja vendore, pranë kësaj bashkie nuk ka informacion të saktë nëse viktimat e dhunës në familje i nënshtrohen egzaminimit të mjekut ligjor dhe nëse rrjedhimisht lëshohen raportet përkatëse të cilat duhet të bëhen pjesë e dosjes së viktimës.
- Pothuasje të gjitha rastet e dhunës referohen pranë gjykatës nga Policia Vendore e Bashkisë Kamëz dhe SPZ në bashkëpunim me koordinatoren vendore janë të parët që ndjekin rastin.
- Objektivi 3.3 për rehabilitimin e dhunuesve nuk identifikohet aspak nga mekanizmi dhe nuk merret parasysh për të gjetur mundësi alternative meqenëse në këtë bashki nuk ka as organizata që e ofrojnë si shërbim. Megjithëse Tirana ka Zyrën për Djem dhe Burra, kjo bashki nuk e ka menduar si zgjidhje alternative sa i përket përmbushjes së këtij objektivi.

Rekomandime

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Kamzës për vitin 2019, më poshtë renditen disa rekomandime të cilat kërkojnë masa të menjëherëshme për të rregulluar funksionimin e Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Kamëz dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ, kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje:

- Rekomandohet pjesëmarrje e plotë e të gjithë aktorëve të mekanizmit të referimit në mbledhje apo në aksione të koordinuara midis tyre. Veçanërisht është e domosdoshme prezenca dhe bashkëpunimi i institucioneve si: Zyra e Përmbartimit Shtetëror; Zyra e Shërbimit të provës, Gjykata apo/dhe Prokuroria.
- Bashkia e Kamzës duhet të ketë komunikim të vazhdueshëm për marrjen e UM/UMM që i përkasin komunitetit të kësaj bashkie nga gjykata e rrethit Tiranë.
- Koordinatorja e MKR-së e emëruar në mars 2019 duhet të ndarjë në mënyrë të rregullt informacionin dhe hartimin e raporteve të takimeve të GTN-së. Vetëm mbajtja e minutave të takimit apo listë prezencave nuk i shërben ofrimit të shërbimeve apo ri-integrimit të viktimës së dhunës në shoqëri.
- Komiteti Drejtues duhet të mblidhet dhe të shikojë politikën dhe të japë direktiva për përmirësimin e shërbimeve të këtij mekanizmi.
- Bashkia duhet të hartojë një plan ndërgjegjësim aktivitetesh gjatë gjithë vitit në bashkëpunim me aktorët e MKR dhe të buxhetuar si dhe të ofrojë shërbimin e specializuar dhe seanca te herë pas hershme psiko- sociale për dhunuesit duke konsideruar stafin e saj të trajnuar në këtë fushë.

- Bashkia duhet të krijojë një hartë shërbimesh sociale në territorin e saj për ti ofruar një informacion të saktë viktimave për shërbimet dhe ofruesit e shërbimeve.
- Në mënyrë që të racionalizohen burimet, është e domosdoshme që Drejtoria e Kujdesit Social, duhet të ketë një databazë me të gjithë informacionin për shërbimet e ofruara individëve, familjeve dhe grupeve vulnerabël, duke specifikuar të dhënat për dhunën në familje. Ky informacion do të ndihmojë edhe bashkëpunimin me organizata private të specializuara në fusha të ndryshme, për të plotësuar spektrin e shërbimeve.
- Të vihet në efikasitet sistemi REVALB.
- Përmirësimi i mekanizmave dhe kapaciteteve profesionale nëpërmjet ofrimit të trajnimeve të vazhdueshme për stafin është një mundësi e mirë për bashkinë që të ofroj shërbime sa më koherente dhe me standarde.
- Bashkia në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare të mbështëtura dhe nga donator të huaj të ofroj trajnime të vazhdueshme për antarësinë e MKR Kamëz që të ofroj shërbime sa më koherente dhe me standarde.
- Në vazhdim të ofrimit të trajnimeve bashkia duhet të trajnojë stafin e punonjësve të shërbimit social sidomos atyre të Njësisë administrative mbi rolin dhe përgjegjësitë që përcakton ligji nr.121/2016.
- Bashkia në bashkëpunim me OSHC duhet të punojë për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit të grupeve të rrezikuara, specifikisht me programe sensibilizues të këshillimit dhe mbështetëse për çiftet e reja dhe nenat.
- Rekomandohet që të shikohet me përparësi rikthimi i Zyrës së Punës Lokale pranë kësaj bashkie.

Për më shumë informacion në lidhje me këtë raport kontaktoni

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

E-mail: gadc@gadc.org.al

Adresa: Rr. “Abdyl Frasheri” Pallati 10/1, shk.1, ap.3, Tiranë